

“Mjedisi Sot”
Nr 2202 E Merkure 26/09/2007

Pergatitur nga Qendra Rajonale e Mjedisit

Rr. Ismail Qemali, Nr. 27, Kati III

Kutia postare 127, Tirane

Tel/Faks (+355 4) 23 29 28

Email: info@albania.rec.org

Web: <http://albania.rec.org>

www.mjedisisot.info

PERMBAJTJA

NGA VENDI

- Kryeqyteti, vendi i zhurmes dhe i ndotjes masive te ajrit
- Kukes, 6000 hektare pyje te djegura
- Fier, agjencia e mjedisit, gjoba kompanive te naftes
- Elbasan, test per perpunimin e mbeturinave
- Pakete turistike per bjeshket e nemuna

NGA BOTA

- Bashkimi evropian u ofron ndihme vendeve ne zhvillim per ndryshimet klimatike
- Ende asnje marreveshje midis norvegjise dhe bashkimit evropian per tregtimin e karbonit

Njoftime

- Seminar per prezantimin e Planit Strategjik te Veprimit te Kapaciteteve per Menaxhimin e Integruar te Mjedisit
- 11th international specialized conference on watershed & river basin management

Te gjitha OJF-te mjedisore dhe ato qe kryejne aktivite per mjedisin, jane te mirepritura te

dergojne informacione ose njoftime, ne adresen 'Mjedisi Sot' info@albania.REC.org, ose Kutia Postare 127, Tirane.

Pergatitja e lajmeve ditore eshte mundesuar ne saje te mbeshitetjes nga Agjencia Spanjolle per Bashkepunim Nderkombetar – AECI.

Nga VENDI

Kryeqyteti, vendi i zhurmes dhe i ndotjes masive te ajrit
B.Disha, gazeta Metropol

Ajri sa vjen dhe behet gjithmone dhe me i ndotur ne vendin tone. Nga te gjithë monitorimet qe jane bere, kryeqyteti konsiderohet si nje nder vendet me te ndotura duke e tejkaluar shifren e azotit (NO2) ne piken e 21 dhjetorit. Gje e cila nuk sjell asnje te mire per banoret qe jetojne aty, madje tani Tirana mund te behet vatra e shume semundjeve te cilat kane mundesi te perhapen me shpejt duke shqetesuar shume qytetaret. Nderkohe qe ajri perbehet nga lende te ngurta pezull (LNP) dhe lende te ngurta te cilat permbajne elemente te shumte negative ne lidhje me shendetin, te cilat llogariten te jene disa here me te larta se normat e percaktuara nga Bashkimi Evropian.

Nga monitorimet qe jane bere, Tirana renditet ne nje nder qytetet me te ndotura si pasoje e nivelit te larte te ndotjes se krijuar nga makinat dhe elemente te tjere. Ku makinat e vjetra dhe cilesia e karburanteve, jane dy nga faktoret kryesore te ndotjes. Keta faktore jane shkaktaret kryesore qe e kane renditur ate si nje nder vendet me te ndotura qe ka Shqiperia kete vit, pavaresisht nga masat e marra deri me sot, ato jane te pamjaftueshme per permiresimin e cilesise se ajrit urban ne Tirane”, thuhet nga te dhenat duke ia kaluar per nga ndotja dhe Elbasanit i cili ka qene renditur per shume kohe si nje vend ku ndotja e ajrit ishte gjithmone ne ngritje te normave te lejuara te dyoksidit te karbonit dhe shkaku i te gjithë kesaj jane ndotesit e fabrikes se cimentos dhe ajo e KURUMIT. Por vlen per t'u permendur se keto fabrika, te cilat kane shume kohe qe nuk i kane perdorur filtrat qe filtrojne ajrin, jane ndergjegjesuar tashme dhe ka qe nga data 19 nentor qe fabrika e cimentos ka vendosur ne perdorim filtra te rinj te kapjes se shkarkimeve te pluhurit, gje e cila ka sjelle ulje te ndjeshme te grimcave te ajrit. Kjo gje ka bere qe te kete nje permiresim te ndjeshem ne pastrimin e ajrit dhe situatave te tjera mjedisore.

Monitorimet

Ndersa nga monitorimi me i fundit i bere nga Instituti i Shendetit Publik ne shtate qytete te ndryshme te vendit, serish gjendja ka rezultuar te jete e rende. Kjo pasi jane paraqitur elemente te shumte ndotes ne keto vende. Keshtu, nga monitorimet qe jane bere per shtate qytetet kryesore te vendit tone, nje nder me te ndoturats eshte kryeqyteti, kurse pas tij vjen Durresi, Elbasani, Fieri, Korca, Shkodra dhe Vlora, ne trembedhete pika te ndryshme. Nga monitorimet qe jane bere kane dale ne rezultatin se nga krahasimi i grafikeve midis qyteteve ne periudhat e dites nga ajo e nates, shihet qarte se nuk ka ndonje ndryshim te madh. Vlerat jane te peraferta midis tyre dhe nuk ka patur ndonje renie te ndjeshme ne vitin paraardhes. Per sa i perket zhurmave urbane, monitorimet u kryen ne tete qytete qe perbejne mbi 30 per qind te popullsisë se Shqiperise dhe kane mbi 60 per qind te automjeteve ne qarkullim. Sipas specialisteve qe kane bere keto monitorime, ndotja akustike ne keto qytete eshte kontribut i nje fluksi me te madh te automjeteve te cilat shtohen cdo dite dhe me shume duke bere qe te vazhdoje ndotja te rritet per dite e me shume.

Shkaktaret

Ky fluks eshte rrjedhoje dhe e amullise se krijuar ne kryqezime nga sasia e madhe e automjeteve,

mosfunksionimi i sinjalistikës në shumicën e nyjeve, i levizjes së mjeteve të renda mbi 10 ton (të cilat vështiresojnë qarkullimin dhe rrisin me 30 për qind nivelin e zhurmave dhe të ndotjeve në vend). Edhe mungesa e vendparkimeve është një tjetër faktor i cili ndikon në rritjen e niveleve të ndotjes nga zhurmat. Këta faktorë dhe të tjerë të cojnë në perfundimin se vendi ynë është një ndër vendet me ndotje akustike urbane ndër me të lartat. Problematikë po bëhet gjendja e padurueshme sidomos në orët e natës.

Qëllimi final i këtyre monitorimeve është perpunimi i kriterëve mbi bazën e të cilave do të krijohen limitet e normave të ekspozimit dhe të nxisin luftën kundër zhurmës si pjesë perberëse e programeve të shëndetësive dhe mjedisit gjithmone brenda kuadrit dhe parametrave perkates.

Kukes, 6000 hektare pyje të djegura
ar. za, Gazeta Shqiptare, fq. 22

Vapa përvëluese e cila nuk mbahet mend të ketë ndodhur gjatë pesë dekadave të fundit, në Kukës dogji rreth gjashtë mijë hektare me pyje dhe kullota duke shkaktuar një dëm të madh ekonomik, ekologjik, jo vetëm në këto rreth, por në gjithë veriun e vendit. Zyrtarisht, Ministria e Mjedisit njofton se në Kukës janë djegur 3.600 ha me pyje dhe kullota. Ndërsa specialistë të pyjeve pohojnë se janë djegur rreth dyfishi i shifrës së bërë publike nga ministri Xhuvëli. "Deri më tani nuk është dhënë asnjë fond për të kompensuar me mbjellje të reja, apo për të paguar kontribues vullnetarë për fikjen e zjarreve", - pohojnë burime nga Drejtoria e Pyjeve. Në fakt, nuk ka qenë në politiken e qeverisë një gjë e tillë, pasi mbi 50 vatrë të zjarreve të shfaqura u cilesuan si zjarrrënie të qëllimshme dhe duheshin fikur nga vete nëdermarrja e pyjeve dhe komuniteti, edhe pse pyjet akoma vazhdojnë të jenë në kompetencën e pushtetit qendror.

Fier, Agjencia e Mjedisit, gjoba kompanive të naftës
I. Mertiri, gazeta Metropol

Kompanitë e naftës me aktivitet të nxjerrjes dhe perpunimit të saj, në Fier dhe Ballsh ndeshkohen me gjoba nga Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier.

Përgjegjësja e kësaj agjencie Angjelina Mertiri ka shpjeguar se kontrolli i ushtruar disa ditë më parë në këto kompani, ka rezultuar me moszbatim të kushteve rehabilituese të mjedisit të demtuar nga aktiviteti i tyre. Kjo ka çuar Agjencinë Rajonale të Mjedisit të firmosë gjobën në shumën prej 2 milion lekesh të reja.

Kompanitë e naftës në Fier dhe Ballsh nuk kanë respektuar procesin teknologjik të parashikuar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, por sipas kushteve të tyre çfarë ka shkaktuar edhe ndotje në shkallë shumë të lartë të mjedisit dhe tokave, si dhe në ujë dhe në ajër.

"Agjencia Rajonale e Mjedisit ushtron kontrolle në të gjithë territorin e qarkut Fier. Në datën 13 dhe 14 shtator është ushtruar kontroll në KPTHN Ballsh, në rafinerinë e naftës në Fier, në TEC-in e Ballshit dhe "Albetrol". Këto kompani janë të pajisur me leje mjedisi, por nuk kanë plotësuar kushtet që burojnë nga kjo leje. Nga kontrollët ka rezultuar se nuk zbatohen kushtet e vendosura në leje. Me vendosjen gjobave të gjitha kompanitë e mesiperme të naftës, kanë marrë edhe afatin e pagimit të tyre si dhe marrjes së masave emergjente për t'iu përmbajtur kushteve të vendosura për mosndotje të mjedisit dhe kryerje të kushteve të kerkuara teknologjike", saktëson Angjelina Mertiri.

Elbasan, test për perpunimin e mbeturinave

Elbasani do te beje te parin test per trajtimin dhe perpunimin e mbeturinave, nga rezultatet e te cilit do te vendoset ngritja ose jo e nje landfilli. Iniciator eshte Kombinati Energjistik me mbeshtetjen e Ministrise se Energjitikes, ndersa faza eksperimentale do te zgjase 6 muaj. Pas kesaj, do te vendoset aplikimi per realizimin e nje impianti modern qe do te perpunoje plehrat e te gjitha zones se Elbasanit. Projekti eshte vleresuar, jo vetem brenda vendit, por dhe ne ballafaqimin mes 8 mije projekteve ne Austri, ku ai shqiptar ka marre miratimin e eksperteve te huaj. Per kete periudhe, specialistet duhet te tregojne, se jo vetem riciklohen shume mbeturina, por nepermjet fermentimit te mbetjeve ushqimore perfitohet gaz metani i shfrytezueshem, energji elektrike dhe pleh tripleks per bujqesine. Ne fazen e eksperimentit specialistet pjesemarres ne kete projekt tregojne format dhe perfitimet. Ata synojne te perpunojne rreth 100 ton ne dite ne rast se do te konsiderohet sukses ky landfill dhe Banka Boterore do te jape OK per 6 milion Euro, qe do te sherbeje per nje sistem modern perpunimi. Fatbardha Duro, inxhinier dhe nje nder pjesemarreset ne projekt, thote se studimi i Oportunitetit per perpunimin e mbetjeve urbane te qytetit ishte nje iniciative e specialisteve dhe sidomos e drejtorit te Kombinatit. Projekti eshte paraqitur edhe ne Austri mes 8 mije projekteve te 300 vendeve ku merrnin pjese Zvicra, Suedia, Austria, Gjermania e shume vende te tjera. "Ai mund te perpunoje te gjitha mbeturinat e Bashkise Elbasan, si dhe komunat e bashkites perreth", tha Duro. Bashkia Elbasan, vitet e fundit ka hasur si problem mungesen e nje vendi per grumbullimin e mbeturinave. Aktualisht nga ana e institucionit vendor nuk ka nje projekt te realizueshem, por mendohet te gjendet nje vend depozitimi.

Pakete turistike per Bjeshket e Nemuna
Gazeta Koha Jone, fq. 28

Ne ju ofrojme detin dhe jodin per pushime, ndersa kosovaret na servirin bukurite e bjeshkeve dhe oksigjenin e alpeve. Nga viti i ardhshem, tregut shqiptar do t'i shtohet per here te pare nje oferte turistike nga Kosova. "Jemi duke identifikuar produktin turistik, ku Bjeshket e Nemuna zene nje vend te rendesishem", pohon kreu i Asosacionit Kosovar te Turizmit, Zeke Ceku. Sipas tij, brenda ketij viti do te arrihet te krijohen dhe paketat turistike, te cilat tentojne te perfshijne jo vetem kosovaret, por dhe vizitore nga vendet fqinje. "Nga fundi i janarit te ardhshem, do t'i ofrojme tregut shqiptar Bjeshket e Nemuna apo Alpet shqiptare, sic quhen ndryshe, te cilat shtrihen ne 6 komuna", tregoi Ceku. Perverc bukurive natyrore te bjeshkeve, vizitoret do te kene mundesi te njihen me traditat dhe zakonet e banoreve te ketyre aneve, si dhe te strehohen ne njesi akomoduese te tipit "kulle" te pershtatura per turistet. Ne kete menyre mund t'i hapet rruga e krijimit te intinerareve te perbashketa nderkufitare mes Kosoves, Shqiperise dhe Malit te Zi. Kosova njihet pak si destinacion turistik nga ana e shqiptareve. Besnik Vathi, operator me eksperience te gjate ne turizmin shqiptar, eshte i mendimit se "nuk jane shfrytezuuar si duhet potencialet turistike mes dy vendeve, pas hapjes se kufijve". Nga ana tjeter, vijon Ceku, "edhe vete kosovaret nuk i njohin mjaftueshem potencialet e tyre turistike dhe jane skeptike per zhvillimin e ketij sektori". Sipas tij, brenda pak vitesh, Kosova mund te shnderrohet ne nje treg plotesues per vendet fqinje te favorizuara nga prania e detit.

NGA BOTA

Bashkimi Evropian u ofron ndihme vendeve ne zhvillim per ndryshimet klimatike
ENDS Europe DAILY 2388

Komisioni Evropian propozoi ofrimin e nje ndihme te re prej 350 milion euro per vendet ne zhvillim, me synim parandalimin e ndryshimeve klimatike.

“Kjo eshte nje nevoje urgjente per nje pjese te vendeve me te varfra”, tha komisioneri i Bashkimit Evropian per zhvillimin, Louis Michel.

Nen Aleancen globale per ndryshimet klimatike, komisioni planifikon te ndihmoje vendet me pak te zhvilluara ne 5 drejtime: zbatimi i masave te pershtatjes, reduktimi i shkarkimeve nga shpyllezimet, marrja e avantazheve ne tregun e karbonit, pergatitja per katastrofat natyrore dhe harmonizimi i ndryshimeve klimatike ne reduktimin e varferise.

Iniciativa do te sherbeje, gjithashtu, si nje forum per “dialog dhe shkembim experience”, meqenese Bashkimi Evropian po perpiqet te marre mbeshtetje per vizionin e tij lidhur me politiken e klimes ne mbare boten, pas mbarimit te protokollit te Kiotos ne vitin 2012.

Per me shume informacion:

<http://europa.eu:80/rapid/pressReleasesAction.do?reference=IP/07/1352&format=HTML&aged=0&language=EN&guiLanguage=en>

ENDE ASNJE MARREVESHJE MIDIS NORVEGJISE DHE BASHKIMIT EVROPIAN PER TREGTIMIN E KARBONIT
ENDS Europe DAILY 2391

Norvegjia dhe Komisioni Evropian ende nuk po arrijne ne nje marreveshje mbi pjesemarrjen e Norvegjise ne skemen e Bashkimit Evropian per tregtimin e shkarkimeve te karbonit. Kjo marreveshje pritej te vendosej ne muajin mars, por deri me tani nuk ka shenja ne kete drejtim.

Ne qender te diskutimeve eshte numri i kufizuar i lejeve te karbonit qe mund te blejne firmat norvegjeze nga jashte, ne kuader te skemes evropiane. Keto leje pritet te luajne nje rol kyc ne planet e Norvegjise per t'u bere vend neutral karboni deri ne 2050-en.

Norvegjia, e cila eshte pjese e tregut te brendshem evropian si vend anetar i zones ekonomike evropiane, do te lidhe skemen e saj te tregtimit te shkarkimeve me skemen evropiane, duke filluar nga 2008. Ne parim eshte arritur te perfshihet direktiva qe perforcon skemen evropiane ne marreveshjen e Zones Ekonomike Evropiane.

Per me shume informacion:

<http://www.regjeringen.no/nb/dep/md.html?id=668>

Njoftime

seminar per prezantimin e Planit Strategjik te Veprimit te Kapaciteteve per Menaxhimin e Integruar te Mjedisit

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave te Shqiperise dhe UNDP Shqiperi do te organizojne seminarin permbylles “Shqiperia – Plani Strategjik i Veprimit te Kapaciteteve per Menaxhimin e Integruar te Mjedisit” (NCSA) ne 27 Shtator, 2007, ne Hotel “Tirana International”. Seminari fillon ne oren 10:00.

Plani Strategjik i Veprimit eshte mbeshtetur ne fushat e perbashketa te tre Konventave te Rios, permes vleresimit dhe analizes se nevojave prioritare te vendit per zbatimin e Konventave Globale

Mjedisore dhe pasqyron ne terma praktike aktivitetet qe duhet te ndermerren per krijimin dhe zhvillimin e kapaciteteve dhe te strukturave mbeshtetese me qellim menaxhimin e koordinuar e strategjik te mjedisit ne Shqiperi. Plani Strategjik i Veprimit te Kapaciteteve do te krijojte nje mjedis lehtesues per ruajtjen e biodiversiteti unik te vendit, do te lehtesoje zbutjen e vulnerabilitetit nen kushtet e ndryshimeve klimatike si dhe do te ndihmoje ne koordinimin e masave qe duhen marre per te luftuar shkretetirizimin dhe degradimin e tokes, duke ndihmuar ne te njejten kohe zbatimin e parimeve te zhvillimit te qendrueshem.

Pjesemarresit e seminarit jane perfaqesues te Ministrive te linjes, institucioneve kerkimore dhe arsimore, eksperte kombetare, OJF, si dhe perfaqesues te institucioneve financuese.

Per me shume informacion kontaktoni:

Klodi Marika

NCSA/SLM

Manager

klodi.marika@undp.org

11th International Specialized Conference on Watershed & River Basin Management

The International Water Association is going to organize 11th International Specialized Conference on Watershed & River Basin Management on 4-5 September 2008 in Budapest.

The Call for Papers in electronic form (CfPe) which gives a summary of the most important information about the conference can be found on: www.iwa2008budapest.org

Water is a challenge for the century.

Exploring the sustainability of our most valuable resource is our business. IWA presents a unique opportunity to engage in 2 days of innovative discussion on the subjects of Water Resource Management, Climate Change, Water Supply Protection, Sustainable Urban Drainage, Pollution Sources & Controls and Monitoring and Modelling.

Join other experts in exchanging ideas and exploring networking opportunities during the IWA Watershed and River Basin Management Conference, 4-5 September 2008 in beautiful Budapest, Hungary. Mark this event on your calendar and begin to plan abstract / paper / poster today.

Topics of the Conference:

Include but are not limited to Water Resource Management, Climate Change, Water Supply Protection, Sustainable Urban Drainage, Pollution Sources & Controls, Monitoring and Modelling.

- River basin management planning under the EU Water Framework Directive;
- River basin management practices in different continents;
- Managing water resources in transboundary river basins with conflicting demand;
- Managing competing uses to protect water quality and quantity;
- Watershed management methods to facilitate water availability for aquatic ecosystem health and human uses;
- Interconnecting sub-watersheds to achieve basin goals;
- Hierarchical approaches to river basin management.
- Monitoring, ecological classification in EU countries and intercalibration;

- State-of-the-art in assessing water and biological quality and integrating data.;
- Programme of measures and ecological state.
- River basin management, advanced computation and decision support;
- The impact of climate change on watersheds, river basins, estuaries and reservoirs;
- Flood control and prevention.
- Effective methods to involve stakeholders and the public into the river basin management planning processes;
- Conflicts and multi-objective management – is it mostly methodology?
- Economics of River Basin Management.

The internet site of the conference is already open (www.iwa2008budapest.org) and interested candidates could submit abstracts under the Registration menu.

The abstract submission period is open until the end of September 2007.

C'eshte "Mjedisi Sot"

"Mjedisi Sot" eshte nje nga botimet periodike te Qendres Rajonale te Mjedisit - Zyra ne Shqiperi. Ne kete botim ditor do te gjeni lajme dhe probleme mjedisore nga shtypi i dites, informacion per aktivite mjedisore nga vendi dhe bota.

Per t'u futur falas ne listen e shperndarjes se "Mjedisi Sot" ose per t'u cregjistruar, dergoni nje e-mail ne adresen: info@albania.REC.org

Versionin e shtypur mujor te "Mjedisi Sot" mund ta gjeni prane Zyres se REC ne Shqiperi.

Lajmet mjedisore ditore dhe "Mjedisi Sot" mujor mund t'i gjeni edhe ne internet: <http://albania.REC.org>
www.mjedisisot.info

C'eshte REC

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) per Evropen Qendrore e Lindore eshte nje organizate nderkombetare jopartizane, joavokate, jofitimpruese qe mbeshtet zgjidhjen e problemeve mjedisore ne Evropen Qendrore e Lindore (EQL), duke nxitur bashkepunimin ndermjet organizatave joqeveritare, qeverive, bizneseve e aktoreve te tjere mjedisore, si dhe duke mbeshtetur shkembimin e lire te informacionit dhe pjesemarrjen e publikut ne vendimmarrjen mjedisore.

REC eshte krijuar ne 1990 nga ShBA, Komisioni Evropian dhe Hungaria. Sot REC, bazohet ligjerisht ne Karten e tij, nenshkruar nga 28 vende dhe Komisioni Evropian, dhe ne nje marreveshje nderkombetare me qeverine hungareze. REC ka zyren qendrore ne Szentendre, Hungari dhe zyrat e vendeve ne secilin prej 16 vendeve perfituese. Shqiperia e ka nenshkruar Karten e REC ne 1992. Zyra e REC per Shqiperine eshte hapur ne 1994. Kjo zyre punon per realizimin e misionit te REC duke mbeshtetur organizatat jofitimpruese, institucionet mjedisore ne te gjitha nivelet, dhe aktore te tjere te interesuar ne fushen e mjedisit, duke mbeshtetur proceset pjesemarrese dhe shkembimin e lire te informacionit. Fushat kryesore te veprimtarise jane: Programi i granteve per OJF-te; Planet Lokale te Veprimit ne Mjedis, Informacioni Mjedisor; Edukimi Mjedisor; Programi i kualifikimit per OJF-te dhe zyrtare te mjedisit, nismat dhe programet vendore e rajonale; etj.

Nese jeni te interesuar te njiheni me cfare ndodh cdo dite ne mjedisin shqiptar dhe neper bote, abonohuni falas ne "Mjedisi Sot", pakete e perditshme elektronike. Dergoni nje mesazh me titull "Abonim" tek info@albania.rec.org
